REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 951/20
Datë/Datum. 16.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: *Kuvendi i Komunës Dragashi*

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: *621-20-5839-1-2-1*

Sa i përket tenderit për *"Furnizimi me material për parandalimin e virusit COVID-19 për nevojat e shkollave të Komunës së Dragashit për vitin shkollor 2020-2021"*

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

MATKOSPHARM SHPK

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)
Shpetim Rrobaj 289

(Adresa)
Prishtine — *10000*
(Vendi) — *(Kodi postar)*
049 159 159 —
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Liman Buzoku
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
matkospharm@gmail.com
(Adresa elektronike)

16.11.2020

(Data e parashtrimit të ankesës) — *(Nënshkrimi dhe vula)*

SH.P.K. MatkosPharm PRISHTINË

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ Jo ☑

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☑ Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☑ Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

AK në përgjigje të kërkesës për rishqyrtim nxjerr vendim me datë 11.11.2020 duke e refuzuar kërkesën e OE "Matkospharm" Sh.p.k.-Prishtinë si të pa bazuar.

Në këtë vendim, AK ka konstatuar se pretendimet kundrejt OE "Samire Osmani" B.I. janë të paqëndrueshme.

Lidhur me certifikatën nga AKPM-ja, AK konstaton se OE i rekomanduar e posedon certifikatën me shumicë. Mandej, lidhur me certifikatat CE dhe ISO, AK konstaton se OE i rekomanduar i plotëson sipas kërkesës në njoftimin për kontratë.

Tek katalogu me produktin nr.1 (spërkatës 1000ml), AK konstaton se katalogu është konform kërkesës.

Ndërsa, në lidhje me dy pretendimet ankimore që kanë të bëjnë me:

- Mos dorëzimin e deklaratës së përbashkët të grupit të operatorëve ekonomik përmes të cilës caktohet lideri,
- certifikatat ISO dhe CE të cilat janë dorëzuar me afat skadimi për produktin Nr.5OXIMETER,

Për këto dy pika AK nuk ka kthyer fare përgjigje edhe pse në bazë të nenit 108/A të LPP-së ka qenë e obliguar.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Dosja e tenderit, neni 11.1
Dosja e tenderit, neni 9.1&9.2
Neni 59 i LPP-së.
Neni 108/A i LPP-së

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

1. Në dosjen e tenderit të publikuar me datën 24.09.2020 tek Neni 11.1"Krijimi i një grupi të operatorëve ekonomik "Pika c. një deklaratë të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit", - Nuk është dërguar deklarata nga të dy OE Samire Osmani dhe UNIMED, ndërsa po të njëjtit kanë aplikuar si Grup i Operatorëve Ekonomik.
2. Neni 9.1&9.2 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses minimum 3 kontratë për furnizime të ngjashme gjatë tri viteve të fundit nga data e publikimit te njoftimit për kontratë. OE ka ofruar kontrata dhe referenca jo të natyrës të njëjtë si kërkesa e produkteve në tender mirëpo shumicën i ka dërgu DDD.
3. Kërkesa për CE dhe ISO Neni 9.1&9.2 Pika 3. Certifikatë ISO dhe CE -(Valide)-Kopje)- OE ka dërguar CE me afat skadence të skaduar për produktin Nr.5OXIMETER (e bashkangjitur CE me datë të skadencës të dërguar nga OE)
4. Për produktin Thermometer CE nuk është e verifikuar, nëse kyçemi në website për verifikimin e CE (https://www.certipedia.com/certificates/02004016?locale=en) me këtë nr. të CE 2004016 na rezulton tjetër CE certifikatë dhe tjetër model i produktit. Modeli "EP071407-X" ndërsa në CE të OE është modeli "ZLK-IRT101"(të bashkangjitur foton e verifikimit ne websiten e cekur më lartë)
5. Tek katalogu për produktin nr. 1 nga AK është kërkuar Spërkatës 1000ml ndërsa OE në katalogun e tyre kanë ofruar spërkatës 300ml (të bashkangjitur dëshminë e aplikimit nga OE).

Ndërsa, në lidhje me dy pretendimet ankimore që kanë të bëjnë me:

- Mos dorëzimin e deklaratës së përbashkët të grupit të operatorëve ekonomik përmes të cilës caktohet lideri,
- certifikatat ISO dhe CE të cilat janë dorëzuar me afat skadimi për produktin Nr.5OXIMETER,

Për këto dy pika AK nuk ka kthyer fare përgjigje edhe pse në bazë të nenit 108/A të LPP-së ka qenë e obliguar.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*